REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primljeno Më/Dana 15-05-2024 vit.god.

| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
|---|---|---|---|
| 01- | 060 | /01- | 730 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# FTESË

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **V** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **22.05.2024 (e Merkurë),** në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Konferencave në objektit e vjeter të komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytezim të pronës komunale (kijoskave) përmes ankandit publik.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së palujshme të komunale (kijoskave) tek Shtepia e Kultures Gursel e Bajram Sylejmani në shfrytëzim afatshkurt prej 15 vite.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjës së Interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë me numer protokolli 01-110/05-306 të datës 29.03.2024.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për Financimin e shujtave ditore për sherbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të Komunës së Vitisë janar-dhjetor 2024, vendimi me numer protokolli 01-110/05-308 të datës 29.03.2024.**
6. **Informatë Manifestimi Tradicional Kulturo-Sportiv "Flakadani i Karadakut 2024"**
7. **Informatë nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbleljet pranverore 2024.**

**Viti, më 15.05.2024**

**Me respekt!**
**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bekim Azizi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL

## NGA MBLEDHJA E KATËRT E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **22.04.2024 (e Hënë),** në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ilir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj. Majlinda Shabani, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, përfaqësuesi i OSBE-së! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e katërt të rregullt të KPF-së për këtë vit. Kemi pranuar konfirmim për vendimin për hartimin e hartave zonale, ndërsa të tjerat i presim. Para se me hi në rend të ditës hapi diskutim jashtë rendit të ditës.

**z.Ilir Zuka:** Përshëndetje për të gjithë! Fillimish me lejoni të ju falemenderoj për pjesmarrjen më 19 prill. Ju falenderoj në emrin tim dhe në emër të kryetarit të këshillit të fshatit që keni qenë pjesëmarrës në këtë manifestim. I kam dy pyetje kryesues. Problemin e KF "Vllaznisë" e dim të gjithë, ne do të luftojmë deri në pikën e fundit, se jemi në të drejtën se është një problem se edhe në ligën e pestë nëse na qesin, ne do të vazhdojmë garat, nuk mundet një klub me traditë 50 vjeçare me na shu, po ne e kemi një problem tjetër, na e kemi lëshu zhveshtoren edhe jemi mundu edhe me kryetarin që me kompaninë që i ka përfundu punimet, kerrsh bre e kanë ba atë stadium bre. Kemi fol edhe me mbikëqyrësin e projektit, edhe me kompaninë, e ka thirrë edhe kryetari disa here, kërkoj që deri në Kuvend me ardh me e rregullu, sepse krejt pllakat jane tu prish, uji nuk dijet nga vjen, duhet me intervenu me e rregullu sa me shpejt, sepse është ka shkaterrohet. Aty janë mbi 150 fëmijë që ushtorjnë, është gjynah me shku posht ai investim. Kërkoj që sa më shpejt me intervenu, sepse hala su bë një vit që e ka përfundu kompania. Edhe një kërkesë nga "Lagjeja e Muhagjerëve" të cilat vazhdojnë me problemin e kanalit. Unë e kam pas një takim para dy dite me ta, ata i kanë thirrë edhe media, duhet me interevenu aty me rrergullu atë, sepse një individ është pengesë aty që po i pengon atij. Kjo është pronë publike, sepse edhe këtë vit sun marrim asgjë nga ajo tokë.

**z.Jakup Demiri**: Iliri e qeli si temë stadiumin e Pozharanit. Para dy vite ke qenë si temë e ky problem e din Iliri që nuk janë bë punimet siç duhet, e tash po del që ka pas telashe e për të cilat kemi fol edhe me herët. Edhe unë mendoj që të bëhet një komision nga pozita e opozita e t'i përcjellim qeto punime. Nuk e di kush është mënagjer i kontratës, ama duhet me e rregullu.

**z.Ilir Zuka:** Unë i kam edhe të shkrume, edhe kompanisë edhe Florimit si mbikëqyrës i projektit, që të rregullohet kjo çështje, sepse ujë del aty e nuk e din askush nga del ai ujë. Kompania thotë që është dëmtu gypi kryesor. Unë nuk e di këtë, ama kompania duhet me e rregullu këtë. Edhe problemi i shkollës së Pozharanit, a e dini që as një dit nuk është punu aty, bash as një ditë. Kam informacione që kompaia ka dorëzu kërkesë që, më shumë që e kam barr tenderin. Nuk mundet me i mbulu punët, d.m.th çka po ndodhë këtu, a dy vite janë shty kompanitë për këtë tender. Po e thamë me emër, se Reshat Kamberi nuk kryn punë, ky "Vllaznin" e Pozharanit e ka lanë pa stadium e ka me na lan edhe pa shkollë.

**z.Jakup Demiri:** Ini, ty ta kam dhanë informatë se kush është ajku e ti nuk e ke besu ne fillim. Nuk ka qenë halli im Shpend Musa po ka qenë që u blloku qëllimisht shkolla e Pozharanit. Edhe atë ditë që e ka marr kjo kompani, unë qetu kam thanë që, kjo kompani që e ka marr nuk është serioze. Ka ka punu ajo nuk ka kry punë.

**z.Ilir Zuka:** Ky punëkryes neve Pozharanit na ka lanë edhe pa fushë të futbollit. Fusha e futbollit minimumi duhet me i pas 102 metra, kur ka ardh federata me pranu teknikisht, po ju thamë që kundërligjshëm e ka pranu, sepse punëkryersi në kontratë e ka fushën 102 metra, e a i e ka lanë fushën 100 metra. D.m.th duhet edhe një here me prishë këtë fushë e i njëjti vazhdon prap me marr punë e e cila nuk të përfill hiq.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Te shkolla mundemi me marr naj informatë e për me pas naj ndikim e kemi problem nga prej këtu. Te kompanitë është problemi tek mbikëqyrsat, sepse duhet me u keshyrë puna.

**z.Hasan Aliu nënkryetar i Komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Po konsideroj që po shtrohet tema të përseritura. A duhet të shtrohen këto tema, tham që po, duhet me u zgjidhë këto tema. Çështja e pjesëmarrjes në manifestimin e 19 prillit e kemi obligim moral e njerëzor. Çështjen e "Vllaznis". E dimi problemin në mes saj dhe federates, duhet të ndjeken të gjitha rrugët ligjore. Tek intervenimi në zhveshtore të stadiumit duhet të shikohet mundësia tek Zyra e Prokurimit, a ka afatë të garancionit. Nëse ka afatë duhet të insistohet. Unë nuk e di më teper çka duhet me bë kur mbikëqyrësi ka qenë i të njëjti lokalitet. Problemi i kanalit te "Lagjeja e Muhagjerëve" është në procedurë, është çështje e kohës që duhet të zgjidhet. Sa i përketë formimit të komisionit për mbikëqyrje të punëve, jam edhe unë që të shtohet përgjegjësia. Sa i përket shkollës, e di që mbikëqyrësi ka thanë që ka dëmtime të punëve nga punëkryersi paraprak dhe nga keqbërësit. E ka bë një kërkesë ai, me sa e di ministria ja ka pranu kërkesen. A ka kompani të papërgjegjshme, po ka, këtë problem po e kemi.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Për këtë mbledhje kemi parapa këtë:

## Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2024.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit Nr.01-110/05-111, të datës 01.02.2022, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për rendin e ditës.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Me lejen e juaj mua më kanë ardh dhe 2 pika të rendit të ditës, propozim vendim për aprovim për bartjen e mjeteve në një projekt në projekte tjera në shum prej 148 mi e 376 euro dhe e dyta jemi deshmitar të asaj që e kemi një stacion të autobuseve të cilet kem pas bë disa investime që e kemi lanë nën meshir që aty qdo ditë thirren gazetaret mos mirmbajtja e tyre shkakon edhe problem dhe ka ardh jnë propozim vendim për nisem të kryetarit të Vitis për bashkpunim nderkomunal e komunen e Gilanit në fushen e dhenjes në shfrytzim lokacionit të stacionit autobuseve të Vitis nëpërmjes stacionit të autobuseve Gjilan për realizmin e projektit me interes të perbashket, ju e dini që edhe një here e kemi pasë këtë është ndalë ajo iniciativ ka pas propozime të ndryshme por nuk ka mundesi përshkak të formimi psh që të jetë një kompani ndoshta e nivelit komunal përshkak që duhet dhe formim të bordit dhe krejt ato kushtojn dhe si rrug e vetme për momentin është kjo, ju jeni ata të cilet duhet të vendosni me dhanë, a duhet ta lajmë në atë gjednje unë thamë jo se me të vertet po shkaktohet ndoshta edhe mendimi për me investu tash në atë objekt i cili është i frekuentum edhe prej qytetareve edhe prej nxensve ndoshta nderimti nuk të lejon me ndermarr për momentin forma më e mirë e mundeshme do të ishte të kontrollohet dhe shum dokuri që munden me qen devijande në ato hapsira ndoshta edhe binë kur ka menaxher të projektit.

**z.Jakup Demiri:** Të flas më së pari për punen e stacionit të autobuseve. Nënkryetar, ne kemi qenë në muajin janar, kemi vizitu stacionin e autobuseve. Aty përveç parregullësive, disa dëmtimeve që janë, është dhe çështja e tualeteve që janë në gjendje teper të rëndë. Nuk e di, inspektorët në Komunen tonë çfarë pune kanë, se në atë gjendje fëmija me u sillë aty pari është e pafalshme. Është detyrë e pakryeme e inspektorëve. Unë e di që qajo nuk është kanë shumë që u dashtë kompania e cila e ka, se dikush e ka stacionin, se dikush është përgjegjës dhe tash nëse nuk i kanë kry ato a ka ndonjë gjobë, se ndoshta ja japim Gilanit, por ndoshta prapë ajo kompani e

mirë ose një kompani e papërgjegjshme si ajo gjendja është problemi, se nuk është problemi operimeve, se nuk kanë çka me ba edhe Gilani edhe kushdo, se qata nuk di naj sen që mujnë me zhvillu aty tjeter. Nuk jemi ne kundër asnjërit, por kur ka mundësi komuna jonë me shfrytëzu, me udhëheq operatori jonë, ne me qenë ma lokalist. Po tash nëse nuk ka dhezë e kemi provu ne, nomral që jo Gilanit por kushdo që e man më mirë se është në pyetje shendeti i nxënësve, por ta gjejmë një zgjidhje e cila është më e mirë. Kam shku e kam vizitu, neve na ka thirrë KTV, nuk është që e kemi thirrë ne si opozitar, nuk është se e kanë sanu gjendjen, kanë shku mas ca ditëve vetëm ka qenë dera e mbyllur e tualeteve jo më shumë, nuk e di a e kanë pastru apo jo. Tek pika e bartjes së mjeteve në rregull është, brenda 3-mujorshit që është dhe në rregull, por e kam bërë një pytje në muajin dhjetor se sa ka mbetë borgj, mirëpo shefi i Zyrës së Prokurimit ka thënë që nuk kemi asnjë borgj, këtu është ndryshe. Ndërtimi i ujësjellësit në fshatrat Ramjan, Novosellë në shumë prej 60 mijë euro. Ka kompani që nuk është kompensu as me 60 mijë euro. Tani realizimit i buxhetit nuk po delë i sakt.

**znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë:** Këto grande kanë me u marrë tek grandi qeveritar.

**z.Jakup Demiri:** E pikërisht tek grandi e kemi një problem, se grandi e ka një afatë.

**znj.Majlinda Shabani:** Dhe a kanë qenë të planifikume për diçka tjeter në moment që po i destinojmë për diqka tjeter, se paraprikisht është bërë planifikim.

**z.Ilir Zuka:** Kryesues, ne edhe para shumë vjeteve e kemi diskutu. D.m.th e ceken edhe prej ekzekutivit. Çdo punë që kryhet si mos ta ka një mirëmbajte dhe një mbikëqyrje, ajo punë veç po kryhet dhe po kthehet në gjendje hala më keq se me fillu punimet. Stacionit i autobusëve duhet me u dhanë menjëhere në mbikëqyrje. Ajo është shtëpi pa domaqin, ka qenë një stacion i mirë dhe me u kthy në atë gjendje është gjynah për ato nxanësa për krejt ata. Drejtoreshë, këtë unë jam për me kalu. Uroj që nuk na e kthen ministria.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ne e dimë që vitin e kaluar kanë qenë 100 mijë euro për ujësjellësin e Ramjanit. A janë pagu këto pare. Nëse nuk e ke sjellë në Kuvend, ndërsa tek kjo pjesa tjeter, më vjen keq që nuk je konsultu nënkryetar me mu për këtë çështje, unë jam kundër për këtë pikë me qu, nuk jam me dhanë stacionin e Vitisë. Ne kemi kompani që i mirëmbanë objektet komunale. Unë jam për me bë një kompani që me e mirëmbajtë staacionin, personalisht po flas.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Tek çështja e konsultimit, d.m.th pse ka ardh kjo këtu pa u konsultu. Unë besoj që është në kohë, se nuk të ka dalë në Kuvend, por të ka dalë në KPF, dhe ka mundësi të diskutohet. Edhe tek çështja e dytë, për cilën edhe në atë kohë ke qenë kundër, e ka dëshmu që gabim jemi kanë se kemi një gjendje të mjerushme. Jakup, televizioni më ka thirrë dhe mu, me datë 5 unë kam qenë në Smirë, Lubishtë. Ka qenë fillimi i regjistrimit të popullatës, prandaj kam thanë, nuk kam asnje mundësi sot të jem, se e kam intinerarin. Kam mendim se duhet me ja dhanë, asnjë interes i imi nuk është, as personal, as institucional, por një gjendje të tillë në rastë se ne e tolerojmë aty, nuk ke kompani, ligji nuk ta mundëson me formu. Kjo kompani duhet me pas një bord, bordi minimum duhet me i pasë 5 anëtarë, ata duhet të paguhen, për me u pagu duhet me u pagu nga të hyrat e atyre kompanive të cilat i realizojnë dhe lejimi i kësaj gjendje, i këtij shkatrrimi në pamundësi që e permendi Jakupi, por edhe inspektorin sanitar na e kanë marr, e kan bërë regjional. D.m.th nuk ke si Komunë mundësi me thirrë as inspektorin sanitar, se tash i ke 3 inspekorë të cilët veprojnë në aspekt regjional, dhe tu i pas parasysh krejt këto vështirësi, unë konsideroj forma më e mirë e mundshme është kjo. Në momentin që ti e jep lejen, se nënshkrimi bëhet në mes 2 kryetarëve dhe kërkohet përgjegjshmëria shumë më e madhe, dhe kemi të drejtë me shku me konotrullu, me thanë se ke mirë dhe merri këto masa. Ne kemi bërë një investim, por e kemi lanë stihi. Stihi është në mënyrë të pakontrollume që thirren aty. Unë jam shefi që asnjë aty nuk është shefi, ata veç i shfrytëzojnë pa pare, por megjithatë nuk menaxhohet. Unë e di, drejtori i shërbimeve publike kur ka shku me vendos drynin, se nuk ka pas formë tjetër. Ajo nuk është zgjidhje, se nuk është zgjidhje me vendos qelsin, zgjidhje është me ndërtu objektin edhe me ja dhanë dikujt në menaxhim dhe kryhet. Ka pas zëra që edhe strehimoren e bënë. Mundesh me bë, por s'un e man, prandaj është aspekti regjional. Në këtë duhet të veprojmë në kuader të fushës, hapësirave ligjore. Nuk është mirë me stopu këtë çështje, se kemi stopu për 7-8 vite dhe na ka dalë keq. Unë besoj që edhe ti e ke këtë bindje, që duhet me i bë zgjidhje, por për me i bë zgjidhje nuk kemi për momentin. Ne mundemi me shiku e japim për 1-2 vite, i këqyrim mundësitë tonë në rastë se muj për pavarësim. Edhe unë jam për atë me mujtë çka ka në territor tonin i pavarësoj krejt, por

duhet me kqyrë aspektin potencial tonin financiar të mbulueshmërisë. A kemi mundësi, une kete nuk e kemi. Unë nuk muj me bë Komunën e Vitisë me 200 mijë banorë.

**znj.Majlinda Shabani:** Neve na është bërë ftesë prej KTV-së me datë 30 janar, ku ka qenë tu mbajtë seanca e KK-së. Kemi dalë te vendi i ngjarjes. Adresa e parë kur të është një problematikë shkon tek opozita, sepse opozita e shef me një sy tjeter prej pozitës. Unë këtu po e shofë 7-8 vite është diskutu shumë. Fillimisht unë po e shofë një mosvullnet dhe gatishmëri prej anës së kryetarit që me marrë përsipër, që stacioni i autobusëve mos me ardhë në atë gjendje. Ne është dashtë me pritë me ardh një TV prej nivelit qendror, me i bë disa fotografi dhe ato mu publiku dhe realisht ka qenë njëra prej imazheve më të kqia prej Komunës së Vitisë që kemi mujtë me i pa kohët e fundit horror ka qenë ajo pamje, përpos kësaj që tualetet jan shfrytëzu dhe për dukuri negative dhe vazhdimisht ka pas njerëz që kanë shku. E kanë pa dhe ne, është dashtë me bë kaq të madhe temë që me ardh kryetari i Komunës me thanë që, zgjidhja më e mirë nuk po themë, por zgjidhja më e leht më e mira kishte me qenë që, Komuna mu funksionalizu dhe normalisht me qenë e Komunës. Po në situata ku nuk kemi zgjidhje tjeter, normalisht që ne nuk mundemi me lanë në atë formë që me vazhdu prapë dhe mos me qenë funksionale me u shkatrru objekti, aty jan thy gjamat, prapë duhet me investu prapë duhet me u rregullu përveç tualeteve, hapësira e jashtme e brendshme, d.m.th është dashtë me pritë qekaq kohë të madhe dhe mandej kryetari i Komunës me shprehë gatishmëri, dhe në këtë rastë me ofru këtë zgjidhje që nuk po thamë që është më e mirë, po në rastë se nuk kemi zgjidhje tjera duhet me vendos dhe këtë formë ne që mos me lanë këtë imazh të keq që ju është bërë i Komunes së Vitisë, dhe realisht stacionit të autobuesve. Unë po shpresoj që kur të jepet të shikohen edhe rruget më të mira, që Komuna e Vitisë me pas përfitim këtu. Te tjetra, tek mbikëqyrja e punimeve, tek komisioni që edhe unë jam pro propozimit që e bëri Jakupi, për formim të komisionit, dhe besoj që kjo kërkesë ka me u marrë parasyshë, sepse kemi parë që janë tu bë shumë punime në Komunën e Vitisë. Realisht tek çështje e asfaltimeve, mirëpo sa i përket kualiteteve dhe punimeve që bëhen janë 2 tema të ndryshme. Nuk muj me i përzi në profesionin e dikujt tjetër, mirëpo ajo që ne shohim në sytë tonë dhe qytetarëve, çdo ditë thojnë që kualiteti i punimeve është shumë i dobët, andaj dhe unë po konisdeorj që mbiqyrja e punimeve dhe formimi i komisionit prej anës së opozitës duhet me u bë sa më shpejtë që këto punime me u kry siç duhet.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Majlindë, unë po pajtoj plotësisht, veç nuk po pajtoj aty që gatishmëria e kryetarit ka qenë dhe kur kemi investu është blloku nga ana e opozitës, për shkak që ka mendu, ka pas qasje tjetër. Unë nuk po du me thanë që as ata e kanë pas më mirë, por koha e ka dëshmu se kem gabu, se më mirë është me ja dhanë dikujt i cili nuk na qonë në atë gjendje. Për që ju ka thirrë TV ju thashë më ka thirrë dhe mu me të 5-së. Unë nuk e kam thirrë, më kan thirrë ata me dalë, ju kam tregu që atë ditë atë intinerar kam, ju kam thanë që tjeter ditë kurdo hajde, por sot nuk muj se ka me qenë në Smirë, Lubishtë dhe ka me qenë te Plus Televizion për fillimin e regjistrimit të popullates dhe shancë nuk kam pas. Nuk po ja za për të madhe pse ju kanë thirrë juve, ata dikan duhet me thirrë, duhet një çështje që unë besoj se është një emrues i përbashkët. A duhet të jetë stacioni në këtë gjendje, krejt pajtohemi që jo. Cila është forma më e mirë e mundshme, për momentin është kjo dhe unë konsideorj që duhet me pas këtë në konsideratë dhe me i dhanë leje me shku në hapa të mëtutjeshëm. Tek lidhja e kontratës, a kemi aspekt ligjor, duhet ta shikojmë me Fatlumin që ta kushtëzojmë deri në këtë kohë, por gjendjen ta ndryshojmë, jam pro kësaj çështje. Nuk po flas as si pozitë as si opozitë, por si qytetar që e du Komunen e Vitisë me pa mirë.

**z.Jakup Demiri:** Krejt në rregull, pa hi në detaje, po çka ka rëndësi. Këtu ka rëndësi me bë punën të cilën duhet me bë, do të thotë duhet me ardh një televizion.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Jakup, këtu nuk po pajtoj, se ne edhe në fillim kemi qenë para 7-8 viteve pa ardh televizioni.

**z.Jakup Demiri:** Para 7-8 viteve edhe aty kam përgjgjje. Ka qenë një marrëveshje e brendshme e kryetarit, që e kemi diskutu atëhere me dikan, ka qenë çështje korruptive që unë se kam votu.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Nuk është korruptive.

**z.Jakup Demiri:** Ka qenë, sepse ka qenë marrëveshje mes 2 njerëzve. Unë ta jap stacionin e autobuseve, unë po e themë publikisht.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Jo nuk është ashtu, apet tash shkon përmes kryetarit të Komunës dhe atëhere kështu ka qenë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** E njëjta kërkesë ka qenë nisma.

**z.Jakup Demiri:** Qashtu ka qenë, se e di këtë, ta kam thanë informacionin qysh po ta themë dhe sot, se nuk e mshefi, se nuk jam tu punu msheft, por me qenë qajo gjendje dhe mos mu diskutu hiq nuk është në rregull prej kryetarit ose prej neve krejtve me qenë qajo gjendje qaty, me shku fëmija të pakten janë gjysma e nxënësve që frekuentojnë aty.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** A po e nin veten fajtor për kohën që e ke lanë në këtë gjendje.

**z.Jakup Demiri:** Për aq sa më takon po. Jo unë nuk e kam lanë unë, unë atëhere kam mbrojt formën korruptive. Unë e di si funksionon Komuna jem nënkryetar, e dinë edhe ti, e dinë krejt. A ka dikush gjobë prej këtyre kompanive që funksionojnë dhe që po i del zot? A je i interesum nënkryetar? Unë kam shku, më ka thanë unë e kam kontratën, nëse nuk ka kerkush kontratë, unë ta gjej njerin që më ka thanë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Jo nuk ka kontratë.

**z.Jakup Demiri:** Po, kur e merr vesh kush jam dhe çfarë funksioni kam, atëhere ndryshe ja nisi me folë. Dashti me i përzan dhe gazetarët, në gjendjen të cilën e kam gjetë sado që është inspektori regjional, e krejt kemi të drejtë për aq sa përgjegjësi sa më takon marrë, nuk kemi të drejtë me lanë një gjendje të tillë kur i kemi fëmijët qaty, jemi përgjegjës për atë punë, për atë që atëherit ka qenë me ja dhanë dikujt, atë e di sakt.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunes:** Jakup Demiri mbaje mend dhe të gjithë këtu, gjithkund aty ku nuk ka pastërti as nuk e di as nuk kam qef me ditë. I bana 25 vite në institucione komunale në punë, të cilat nuk janë në kuader të ligjit të drejtësisë, prosperitetit as nuk du me ditë as nuk e kam ditë.

**z.Jakup Demiri:** Unë 3 here kam folë në Kuvend Komunal për stacionin e autobuseve. Brenda 2-3 viteve përgjigja ka qenë që nuk kemi të drejtë me investu. Unë e di që drejtpërdrejt nuk keni mundësi. Ka disa donacione, investor të ndryshëm që ka mujtë Komuna. Kështu mu kanë përgjigj në Kuvend Komunal. Po flas që kanë qenë dhe tjerat mundësi, por tash kjo gjendje është. Unë nuk jam për mos me ja dhanë kujdo qoftë, por më së pari një operator, kështu që është, po nëse operator nuk ka që është përgjegjës që nuk mu ka prenzentu mu dikush, atëhere kisha pas qef unë me indetifiku vetë kush është dhe me marrë masa ndaj tij.

**z.Ilir Zuka:** Unë fillimisht e ceka, po kam qenë pjesë e Kuvendit si asistent i kryesuesit, e di sakt edhe para sa viteve na ka ardh i njëjti propozim. D.m.th stacioni i autobusëve në Gjilan me marrë në mbikqyrje stacionin e autobusëve në Viti, është i njejti, nuk kemi ndryshu kurgja, por sa kemi psu po e shohemi. Nëse ish jap atëhere, sot nuk kishim diskutu, atëhere si e di unë është diskutu për 3-5 persona me i punësu, është mirë me u cekë në vendim. Unë mendoj që duhet me u dhanë stacioni i autobusëve, duhet me ju dhanë nxënësve, se sot nuk është tu e shfrytëzu kërkush, as në aborr nuk mujnë me nejt nxënësat prej erës nëse ja kishim dhanë para disa viteve nuk kish ndodh kjo me diskutu. Unë po foli në emër të grupit të LDK-së, jemi pro për me qu në Kuvend.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë jam kundër për me shku në Kuvend, stacioni i autobusave në Viti me ju dhanë stacionit të autobusave në Gilan, kam qenë kundër dhe më herët, sepse nuk kam ndonjë informatë tjeter si e kam pas atëhere. Unë e di që këta ka mujtë me e mirëmbajt Drejtoria e Shërbimeve Publike sikur e ka për detyrë që e pagun mirëmbajtjen e objekteve komunale edhe ajo ka mujtë me u mirëmbajt. Unë e di që kjo si të jepet krejt kompanitë kanë me pas shfrytëzim ekstra që hynë që dalin, mirëpo edhe ai çka hynë në WC sikur në Gilan që hynë ka me pagu 1 euro, sikur në Gilan që është edhe ai fëmija qaty që hynë. Nëse na bëhet ajo me hymje, aty absolutisht kjo për mua është e pa pranueshme. Unë jam kanë për me gjetë zgjidhje këtu. Më së pari e qes në votim rendin e ditës: a jeni që të ju bashkohet pika, Propozim për bartjen e mjeteve? Kush është për këtë? Pra, me shumicën e votave pro miratohet. Rendit të ditës të ju bashkohet dhe pika për dhënien e stacionit të autobusëve. Kush është për? Pra, me 5 vota pro, 2 kunder, 0 abstenim hynë kjo pikë në rend të ditës. Tani a jeni që të miratohet komplet rendi i ditës. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Kryesues, unë sot kam takim me rëndësi, por për shkak të reskepktimit edhe si KPF dhe është i rëndësisë të veçantë, e pash me të arsyeshme me qëndru deri tash. Me avoaktin e e popullit duhet me shku në zyre, se është për të drejtat e njeriut. Kalofshi mirë!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Me ngritje të dorës: a jeni për miratimin e procesverbalit? Me të gjitha votat miratohet procesverbali.

Si pikë të dytë të rendi të ditës kemi:

2. **Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2024**

**Znj.Milihate Ajeti, drejtoresha:** Përshendejte për të gjithë të pranishmit! Kemi bërë prezantimin e pasqyrave financare të Buxhetit komunal për periudhen janar-mars 2024. Në këtë raport e keni të bashkëngjitur të gjithë materialin e nevojshëm. Materialin besoj që ju ka ardh me kohë, për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

**z.Jakup Demiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! I kam disa kode këtu me pyet, 11431, kujdestaria e punëve gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës 17 mijë e 112 euro. Kodi 11411, shtesa e veçantë për të gjithë, 7 mijë e diçka euro. Kodi 40440, shërbime trashëguse, këshilldhënëse dhe profesionale, 15 mijë e 400 e diçka. Kodi 13445, shërbime të veçanta kotraktuese, indivudal. Me i mbledh te dyat dalin diku 23 mijë e 648 e 9 cent. 13510 blerja e librave dhe 11152. Mbështetje të veçant për të zgjedhurit. Çka janë pagu këta për të zgjedhurit? Është 11411, faqe 3, nëse nuk e dinë ma bjen në Kuvend. Njëri kod ka të bëjë me trashëgime. Edhe te krahasimet që kam bërë, e kam fjalën për te krahasimet te kodi 13450, shërbime, shtypje, printim i vitit të kalum, kemi pas 15 mijë e 411 euro, e këtë vit kemi 11 mijë e 755 euro. E di që ka dal kontrata e tyre ku I merrni ato pajisjet (nuk degjohet). Kam disa pyetje që do t'i bëjë edhe në Kuvend.

**znj.Majlinda Shabani:** Dhe një sqarim shtesë tek kodi 13630 për shpenzime mjekësore, diku 24 mijë e 512. Se përshembull në vitin 2023 nuk ka pas.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Drejtoreshë, një pyetje e kam këtu 1 milion e sa janë 800/900 mijë që kenë vendime të gjykatave. Unë e di që ka pas vendime të gjykatave, për shkak të msimdhënësve prej cilat kode janë marrë këto pare.

**znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë:** Sa i përket vendimeve të gjykatës, ajo nuk na ka pyet hiq. Ka mujt naj ka marr paret tek shërbimet publike, kanë marr edhe tek Zyra e Kryetarit. Na kanë marr edhe tek komunalitë. Për më shumë informata ju njoftoj në Kuvend.

**z.Jakup Demiri:** Komuna e Vitisë si të gjitha komunat tjera janë të njoftuara që pagesat për vendime gjyqësore tek mësimdhënësit janë me prioritet ligjor edhe nuk e pyet Komunën se ku i ke zotu këto mjete, po jav ka dhanë një mundësi që disa mjete me i lanë të lira që me i pagu keto.

**z.Ramadan Deliu:** Po quditem me Jakupin, kush është ai njeri që guxon me shku me fol me prokurorin, me avokatin që me hi në kësi pazarllaqe.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend? Nga të gjithë u miratu kjo pikë.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-111, të datës 01.02.2022 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

Ndryshimi është tek anëtari që ka vdek. A jeni që të shkon në Kuvend? Me votat e të gjithve miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. **Propozim për bartjen e mjeteve nga një projetk në tjetrin që e diskutum më heret**

**z.Jakup Demiri:** Drejtoreshë, a jeni konsultu me ministri për këtë proopozim vendim?

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që të shkon në Kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës? Nga të gjithë u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. **Propozim vendimi për bashkëpunimin ndërkomunal me Komunën e Gjilanit në fushën e dhënies në shfrytëzim të lokacionit (Stacionit të autobusëve të Vitisë), me qellim të shfrytëzimit nga N.P.L "Stacioni i Autobusëve Gjilan" sh.a. për realizimin e projektit me interes të përbashkët**

A jeni që edhe kjo pikë me shku në Kuvend me ngritje dore. Me 5 vota pro, 2 kundër shkon në Kuvend kjo pikë e rendit të ditës. Atëhere, pasi që nuk ka për debat, me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

**Procesmbajtësi:**
**Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**
**Bekim Azizi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana | | | vit.god. |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 02- | 035/02- | | 651 |

Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitise
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjën Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008 lidhur me nenin 50 shkrona l të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të dates 21.04.2011,lidhur me neni 6 paragrafi I, pika 1.1, neni 8 paragrafi I pika 1. 1 lidhur me neni 14, te Ligit me Nr. 06/L-092 për Dhenien ne Shfrytezim dhe Këmbim te Prones se Paluajtshme te Komunes (Gazeta Zyrtare Nr. 10, prill 2019) ,Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore propozon këtë:

# PROPOZIM VENDIM

## Paraprak per dhenien në shfrytezim të pronës komunale( kjoskës) përmes ankandit publik

**Neni 1**

Me kete propozim vendim, Kryetari i Komunës se Vitise propozon vendimin paraprak per dhenien ne shfrytezim te prones se paluajtshme kjoskës te Komunes se Vitise ne shfrytezim afatshkurter personave fizik dhe juridik, si ne vijim:

1. Lokali-kjosku tek shtepia e Kulturës Gursel e Bajram Sylejmani ka 16 metra katror

**Neni 2**

Afati kohore per dhenien ne shfrytezim te pronës se paluajtshme komunale eshte afat shkurtër me kohëzgjatje prej 15 viteve,

**Neni 3**

Qellimi i dhënies ne shfrytezim te prones komunale eshte interesi publik dhe perfitimi ekonomik i komunes nga prona komunale.

**Neni 4**

Procedurat per dhënien e prones se paluajtshme komunale ne shfrytëzim afatshkurtër realizohet permes ankandit publik, ne harmoni me Ligjin Nr.06/L092 per Dhenien ne Shfrytezim dhe Këmbim te Prones se Paluajtshme te Komunes.

**Neni 5**

Mënyrat dhe kushtet e shfrytezimit te prones se paluajshme do te percaktohen me kontrate, e cila lidhet dhe nënshkruhet ne mes te kryetarit te Komunes dhe pèrfituesi i marrjes ne shfrytëzim tè pronës se paluajtshme ne periudhe afatshkurtër te shfrytezimit, me te drejte te shkeputjes se kontrates edhe para afatit, nëse kjoskui i dhëne ne shfrytezim nuk shfrytëzohet -keqperdoret

**Neni 6**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

**Propozues,Kryetari i Komunës së Vitisë**

**Sokol Haliti**

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIKA E KOSOVËS - OPŠTINA VITINA - KRYETARI I KOMUNËS - PREDSEDNIK OPŠTINE

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101007-02591-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **639/2024** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 14.05.2024 - 14:10 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | VITI / VITINA / VITI |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Viti / Vitina / Viti |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | VITI / VITINA / VITI |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-70101007-02591-0** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | **6003** | | 24.02.2014 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| | | | 24.02.2014 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VITISË ZYRA KOMUNALE PËR KADASTËR

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land | Shtëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building | | 6003 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Vitisë** | 600424486 | / / / | | 28 NËNTORI | **1/1** | permisim i emrit. | 24.02.2014 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Viti

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70101007-02591-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 6003 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:825

Punoi/Obradio/Created: Kushtrim Imeri

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 15.05.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:22:48

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 24-04-2024 viti god. | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.I organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 02- | 035/02- | | 652 |

Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitise
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjën Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008 lidhur me nenin 50 shkrona l të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të dates 21.04.2011, nenit 17. pika 2. lidhur me neni 6 paragrafi I, pika 1.1, te Ligit me Nr. 06/L-092 pêr Dhenien ne Shfrytezim dhe Këmbim te Prones se Paluajtshme te Komunes (Gazeta Zyrtare Nr. 10, prill 2019) ,Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore propozon këtë:

**PROPOZIM VENDIM**

**Për formimin e Komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave per dhenien e prones paluajtshme te komunes –Kjoskut tek Shtepia e Kulturës" Gursel e Bajram Sylejmani "ne shfrytëzim afatëshkurt prej 15 viteve.**

**Neni 1**

Me kete propozim vendim Kryetari i Komunes se Vitise propozon vendimin per formimin e Komisioni per vlerësitmin e procedurave per dhenien ne shfrytëzim te prones se paluajtshme te kKomunes se Vitise: Komisioni propozohet prej 5 anetareve, dy nga ekzekutivi, dy kuvendi i komunes dhe nje nga shoqëria civile.

Albulena Haxhiu, anetar i komisionit (perfaqësues i ekzekutivit te komunës)
Driton Halabaku, anëtare e komisionit (perfaqesuese e ekzekutivit te komunes)
(perfaqesues i kuvendit te komunës, subjekti LDK )
(perfaqesues i kuvendit te komunës subjekti LVV)
(perfagesues i sektorit joqeveritar).

**Neni 2**

Me këtë propozim vendim detyrat e Komisionit nga neni I i ketij propozim vendimi jane percaktuar ne Ligiin per dhenien shfrytezim dhe Kembim te Prones se Paluajtshme te Komunes Nr.06/L-092, i Kuvendit te Republikes se Kosoves (Gazeta Zyrtare e Republikes se Kosoves me Nr. 10, te dates 03.04.2019).
Komisioni vlerêsues udhëheq me procedurat mbi dhenien e pronës se paluajtshme komunale ne shfrytezim pergatit kriteret e ankandit, percakton qmimin fillestar, zgjedhet kryetari i komisionit,vlereson ofertat.

**Neni 3**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

**Propozues,Kryetari i Komunës së Vitisë**

**Sokol Haliti**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
KRYETARI I KOMUNËS - PREDSEDNIK OPŠTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 14-05-2024 vit god. | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 02 | 035/02 | | 721 |

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të nenit 13, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në harmoni me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, kërkesen e Ministris së Administrimit të Pushtetit Lokal me nr. 020-238/-6 e datës 13.05.2024, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

## PROPOZIM VENDIM

**Për shfuqizimin e vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjës së Interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë me numer protokolli 01-110/05-306 të datës 29.03.2024**

**I.** Kryetari i Komunës i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që të miraton vendimin për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjës së Interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë, vendimi me numer protokolli 01-110/05-306 të datës 29.03.2024.

**II.** Me këtë propszim- vendim, i propozohet Kuvendit të komunës së Vitisë që të shfuqizoj vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjës së Interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë, vendimi me numer protokolli 01-110/05-306 të datës 29.03.2024, kërkesen e Ministris së Administrimit të Pushtetit Lokal me nr. 020-238/-6 e datës 13.05.2024.

**III.** Ky vendim hyn fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-238/6 -VI-
Data 13.05.2024

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë<br>Bekim Azizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së<br>Jeton Qela ,Ud. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | Erblin Hetemi,Ud. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë:<br>12.04.2024<br>VI-020-238 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa,Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtim | |
| Lloji i aktit: | Vendim i kuvendit të komunës së Vitisë | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim 01-110/05-306 për dhënien në shfrytëzim afatgjate të pronës komunale përmes shprehjes së interesit në fshatin Budrikë të komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në parkun industrial në Budrikë |
| I miratuar më datë: 28.03.2024 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.04.2024 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si mësipër, vlerëson se akti i komunës <u>nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024, ka miratuar Vendimin 01-110/05-306 për dhënien në shfrytëzim afatgjate të pronës komunale përmes shprehjes së interesit në fshatin Budrikë të komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në parkun industrial në Budrikë i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vitisë është në kundërshtim me Ligjin 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës pasi qe ky ligj nuk rregullon dhënien e pronës në shfrytëzim për Zonat Ekonomike.

Baza ligjore e vendimit ti referohet legjislacionit përkatës që rregullon vendosjen e bizneseve në parkun industrial e rregulluar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Vitisë, duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me ketë vlerësim.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 14-05-2024 vit god | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 02- | 035/02- | | 722 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të nenit 13, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në harmoni me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, kërkesen e Ministris së Financave, Punës dhe Transfereve me nr 020-238/4 e datës 24.04.2024, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

**PROPOZIM VENDIM**

**Për shfuqizimin e vendimit për Financimin e shujtave ditore për sherbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të Komunës së Vitisë janar-dhjetor 2024, vendimi me numer protokolli 01-110/05-308 të datës 29.03.2024.**

**I.** Kryetari i Komunës i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që të miraton vendimin për shfuqizimin e vendimit për Financimin e shujtave ditore për sherbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të Komunës së Vitisë janar-dhjetor 2024, vendimi me numer protokolli 01-110/05-308 të datës 29.03.2024.

**II.** Me këtë propozim- vendim, i propozohet Kuvendit të komunës së Vitisë që të shfuqizoj vendimin për Financimin e shujtave ditore për sherbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të Komunës së Vitisë janar-dhjetor 2024, vendimi me numer protokolli 01-110/05-308 të datës 29.03.2024, me kërkesen e Ministris së Financave, Punës dhe Transfereve me nr 020-238/4 e datës 24.04.2024.

**III.** Ky vendim hyn fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

Kryetari i Komunës,
Sokol Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 02 ... Nr. Prot. 711-1/2024
Nr. i faqeve / Broj strana / No. pages: ... Data / Datum / Date: 24.04.2024
Dolĵaa PRISHTINË/A

HYRESE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 24.04.2024
Njësia organizative: -VI- | Nr. i Lëndës: 020-238/4 | Vlera

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada – Government***

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Sokol Haliti,** Kryetar i Komunës së Vitisë<br><br>**Bekim Azizi,** Kryesues i Kuvendit të Komunës | |
| Kopje: | **Elbert Krasniqi,** Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal<br><br>**Jeton Qela,** ud. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal<br><br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | |
| Përmes: | **Avni Zogiani,** Zv. Minister në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve<br><br>**Enis Spahiu,** ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | |
| Nga: | **Bora Duli,** ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Date:<br>16.04.2024 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br><br>1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor<br><br>2.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor | <br><br>**Razije Murtezaj,** Zyrtare Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve<br><br>**Kimete Zekaj,** Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Referencë:<br>54/2024 |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vitisë | |
| Lloji i aktit: | **Vendim** | |

I nderuari Kryetar z. Haliti,

I nderuari Kryesues z. Azizi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

| |
|---|
| ***Vendim 01-110/05308 për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të komunës së Vitisë Janar -Dhjetor 2024*** |
| ***I miratuar më datë 28.03.2024*** |
| ***I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 03.04.2024*** |
| ***I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më 05.04.2024*** |

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Vitisë, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Vitisë, me anë të këtij akti që është subjekt i shqyrtimit, synon financimin e shujtave ditore për shërbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të komunës së Vitisë Janar - Dhjetor 2024.

2. Si pikë e parë, dhe për qëllime të këtij vlerësimi është me rëndësi të theksohet se neni 12 i Ligjit **08/L-260** mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës se Kosovës për vitin 2024 (këtej e tutje referuar si '**Ligji**') i precizon limitet në shpenzime për organizatat buxhetore.

3. Për të konkretizuar konstatimin e mësipërm, si dhe tregues i rëndësishëm për të vlerësuar limitet në shpenzime në kuptim të shujtave mbetet neni 12, paragrafi 5 i Ligjit, ku përcaktohet se:

   *5. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës.*

4. Nëse elaborohet vlerësimi ligjor krahas frymës së paragrafit 5 të nenit 12 të Ligjit, evidentohet se shpenzimi i parasë publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar, qoftë edhe në formë të shujtave, po ashtu edhe në kategorinë e shpenzimeve paga dhe shtesa nuk janë parapatë ndarjet buxhetore për financimin e shujtave për asnjë kategori.

5. Rrjedhimisht, konform interpretimit të kësaj dispozite, Ministria vlerëson se akti i Komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe për pasojë, Komunës së Vitisë i pamundësohet realizimi i masës së përcaktuar në aktin komunal.

Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Vitisë ndërmarrjen e veprimeve konkrete, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të kërkesës për shfuqizim të aktit, në mënyrë që masa e përcaktuar me aktin e komunës të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Vitisë dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

***Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve***

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 10-05-2024 viti/god

| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
|---|---|---|---|
| 01- | 016/ | 01- | 706 |


24-26 Mars 2024

# Manifestimi Tradicional Kulturo-Sportiv "Flakadani i Karadakut 2024"

# INFORMATË

DKRS/ Viti

**Republika e Kosovës**
Republic of Kosova
**Komuna e Vitisë**
Municipality of Viti/Vitina
**DrejtoriapërKulturë, Rinidhe Sport**
Departament of Culture, Youth and Sports

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | Maj, 2024 |
| **PËR/ZA/TO:** | Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal, Viti |
| **NGA/ZA/FROM:** | Z. Valmir Sahiti<br>Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport |
| **PËRMES/OD/FROM:** | Zt. Bekim Azizi<br>Kryesues i Kuvendit Komunal |
| **C.C** | Zt. Sokol HALITI<br>Kryetari Komunës së Vitisë |
| **LËNDA:** | Informatë për Manifestimin Tradicional "Flakadani i Karadakut 2024" |

**Përmbajtja**

**I. DKRS – TRUPA KOORDINUESE E MANIFESTIMIT……………….. 4**
a) Ndarja e detyrave të Trupës Kordinuese……………………………………..…. 4

**II. RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE………………………..……….5-9**
a) Aktivite Kulturore dhe Sportive…………………………………………...………7-9

**III. RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT……...……………………………..........9-10**
a) Tabela e kostos totale buxhetore……………………..……………………..………......9
b) Tabela krahasuese (2023-2024) e shpenzimeve………………………………....……...……10

**IV. MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT DHE MEDIAT…...…………………...….10**

**b). Ndarja e detyrave të Trupës koordinuese:**



# II. RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE

## *a)* Aktivitet kulturore dhe sportive

- Hapja solemne – Dhezja e Flakadanit

Kemi organizuar dhe mbajtur manifestimin tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut 2024", si një nga ngjarjet më të mëdha kulturore në Komunën e Vitisë, në të cilin marrin pjesë artistët dhe grupet artistike nga mbarë gjeografia shqiptare dhe më gjere.

Kjo ngjarje kulturore dhe sportive, u mbajt në saje mbështetjes së projektit: "Flakadani i Karadakut 2024", nga institucionet komunale, me përkujdesjen e Kryetarit të Komunës së Vitisë Z. Sokol Haliti, si dhe organizimit nga ana e Drjetorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
Manifestimi Tradicional Kulturor e Sportiv "Flakadani i Karadakut 2024" ka filluar më 24 mars 2024, ku u bë hapja solemne e manifestimit me dhezjen e Flakadanit dhe ka përfunduar më 26 mars në mbrëmjen finale të festivalit mbarëkombëtar të ansambleve dhe shoqërive kulturore dhe artistike. Në këtë tubim pos udhëheqjes komunale dhe shoqatave të ndryshme prezantuan edhe deputetët e parlamentit të Kosovës si dhe mysafir të shumtë nga Kosova, Shqipëria, Lugina e Preshevës, Maqedonia e Veriut, Bursa e Turqisë dhe Gjermania.

Vlen te permendet qe kete vit pati prurje të reja dhe se manifestimi tradicional Flakadani i Kardakut merr epitetin e një nga ngjarjet më prestigjioze kulturo- sportive në mbarë hapësirat shqiptare dhe më gjerë.

Aktivitetet Kulturore dhe sportive:

- Ora e Madhe Letrare – u mbajt në sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së kulturës "Gursel dhe Bajram Sylejmani" në Viti, më 26 mars 2024, me fillim në ora 11.00. Në Orën e Madhe Letrare prezantuan shkrimtarë, poetë nga të gjitha trevat shqiptare. E organizuar në koordinim me Shoqatën e Shkrimtarëve "Ramdan Musliu" e cila hapi konkursin letrar, ku me poezitë e tyre kanë konkuruar poetë e shkrimtarë të cilët janë kualifikuar për Orën e Madhe Letrare dhe janë botuar në revistën "Flakdani 2024".
  Juria profesionale në përbërje prej 3 anëtarëve me kryetar Sabit Rrustemi, ka vlerësuar poezitë më të mira të shkrimtarëve konkurrues të Orës së Madhe Letrare- "Flakadani i Karadakut 2024".

  Me çmimin e parë u nderua shkrimtari dhe poetit Nexhat Rexha me poezinë "Fjalë e shkrirë në pagjumësi" nga Kamenica, çmimi i dytë i takoi Farida Ramadanit nga Shkodra, kurse çmimi i tretë u nda për poetin Bilall Maliqi nga Presheva.

  Kurse çmimi kryesor "Flakdani i Karadakut" iu nda poetës Shqipe Hasani nga Prishtina me poezinë "Shpirt me ëndrra atdheu".

- Garat regjionale të recituesve – u mbajtën në Sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së Kulturës "Gursel dhe Bajram Sylejmani" në Viti, më 25 Mars 2024 me fillim në ora 11.oo. Në këto gara prezantuan nxënësit e shkollave të mesme të komunave: Kamenicë, Viti dhe Kaçanik.
  Juria profesionale e përbërë nga përfaqësuesit e komunave përkatëse, vlerësuan që vendi i parë t'i takoi Edona Zenelit me poezinë "Mos ma kujto"– SHM "Feriz Guri" nga Kaçaniku kurse vendi i dytë iu nda Bleona Krasniqit, poezia "Një natë pa gjumë" - Gjimnazi "Ismaijl Qemajli" – Kamenicë, ndërsa me vendin e tretë u shpërblye Arbesa Misini, SHMP "Jonuz Zejnullahu " nga Vitia.

  Për të gjitha shkollat pjesëmarrëse, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si organizatore e manifestimit , ndau falënderime.

- Festivali Gjithëkombëtar i Shoqërive Kulturore e Artistike – u mbajt nga 24 - 26 Mars – prezantuan 14 -të Shoqëri Kulturore artistike nga Kosova, Shqipëria, Gjermania dhe Presheva, ku hapjen e festivalit e bënë solistët e mirënjohur Mehmet Zuka dhe Ismet Bexheti. Kurse mysafir i mbrëmjes finale të festivalit mbarëkombëtar të ansambleve dhe shoqërive kulturore dhe artistike "Flakdani i Kardakut 2024" , ishte Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Shqipe "Shota" nga Prishtina.

Mbrëmja e parë e festivalit, më 24 Mars:

| *Nr.* | *Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria Kulturore* | *Vendi* | *Vlerësimi i Jurisë* |
|---|---|---|---|
| 1. | AKV "KEMAJL AZIZI" | VITI | ***Jashtë Konkurrencës*** |
| 2. | SHKA "DRENICA" | SKENDERAJ | ✓ |
| 3. | SHKA "ZËRI I LUGINËS" | LUGINA E PRESHEVËS | ✓ |
| 4. | AKV "BAJRAM CURRI" | PRISHTINË | ✓ |

Mbrëmja e dytë e festivalit, më 25 Mars:

| *Nr.* | *Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore* | *Vendi* | *Vlerësimi i Jurisë* |
|---|---|---|---|
| 1. | QENDRA KULTURORE "ANAMORAVA" | VITI | *Jashtë konkurrencës* |
| 2. | SHKA "ZËRI I KAMENICËS" | KAMENICË | |
| 3. | AKV "DEÇANI" | DEÇAN | |
| 4. | SHKA "GRYKA E KAÇANIKUT" | KAÇANIK | ✓ |
| 5. | GRUPI I KLEJSENHELMIT | GJERMANI | |

Mbrëmja e tretë e festivalit, më 26 Mars:

| Nr. | *Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore* | *Vendi* | *Vlerësimi i Jurisë* |
|---|---|---|---|
| 1. | SHKA "JONUZ RAMADANI" | SMIRE / VITI | *Jashtë konkurrencës* |
| 2. | AKV " KASTRIOTËT" | FERIZAJ | ✓ |
| 3. | AKV " ILIRIA" | GJERMANI | ✓ |
| 4. | AKV "TIRANA" | TIRANË | ✓ |
| 5. | ASAMBLI SHTETËROR KËNGËVE DHE VALLLEVE "SHOTA" | PRISHTINË | *Mysafire e festivalit* |

Juria profesionale në përbërje: Mehmed Xhemajli koreograf, Sami Piraj muzikolog dhe Mustafë Lamallari profesor i muzikës, vlerësuan dhe ndanë 3 vendet e para, çmimin special dhe atë jubilar të Festivalit Gjithëkombëtar të Shoqërive dhe Ansambleve Kulturore Flakadani i Karadakut 2024"

Vendin e parë iu nda AKV "Tirana" nga Tirana, vendi i dytë AKV "Bajram Curri" nga Prishtina dhe vendi i tretë i takoi AKV "Deçani" nga Deçani. Ndërsa me çmimin special u nderua Shoqata "Iliria" nga Gjermania.

- ✓ Më 26 Mars, me fillim nga ora 10.00, u bënë homazhe dhe vendosja e kurorave me lule te varrezat e dëshmorëve – Dëshmorit Nijazi Azemi – Komandant Mjekrra.

Aktivitetet sportive:

- Garat sportive të shahut
- Garat sportive në gjimnastikë
- Garat sportive të basketbollit

Ku të gjitha ndeshjet u zhvilluan gjatë rrjedhës së manifestimit Kulturor dhe Sportiv "Flakadani i Karadakut-2024.

# III. RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT

## a) Tabela e kostos buxhetore:

| Fondi burimor | Lloji i shpenzimit | *Kostoja në €* |
|---|---|---|
| **Komuna e Vitisë/DKRS** | **Akomodimi** | ***1962.00 €*** |
| **Komuna e Vitisë/DKRS** | Zërmi | ***970.00 €*** |
| **Komuna e Vitisë/DKRS** | Dreka (Shujta për grupet artistike dhe sportive) | ***8003 €*** |
| **Komuna e Vitisë/DKRS** | Rekuizita sportive (fanella sportive, kupa, diploma, etj) | ***539.00 €*** |
| **Komuna e Vitisë/DKRS** | Plus TV | ***2001.00 €*** |
| **Komuna e Vitisë/DKRS** | Ndriçimi profesional, podioumi dhe ekrani led (Skena) për 3 ditë të festivalit gjithëkombëtar "Flakadani i Karadakut 2024" | ***2361.18 €*** |
| **Komuna e Vitisë/DKRS** | Transporti i grupeve artistike mysafire | ***€ 220.00*** |
| **Komuna e Vitisë/DKRS** | Shtypja e materialeve grafike katalogë, cerada citillajda, rollop, postera, shtypja në bez e flamujve beza, gravura, fotografi etj. | ***1635.00 €*** |
| **Totali:** | | ***17,691.18 €*** |

## Tabela krahasuese 2023/ 2024

| ***"Flakadani i Karadakut 2023"*** | ***Flakadani i Karadakut 2024"*** |
|---|---|
| ***26,557.66 €*** | **17,691.18** |
| **-8866.48** | |

## IV. MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT

Mbështetësit: Komuna e Vitisë-Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Mediat: Manifestimi Tradicional kulturor dhe sportive "Flakadani i Karadakut 2024", u mbulua tërësisht nga "Plus Televizion",RTK4, T7, TëVë1, "TV Presheva" , Zyra për Informim e Komunës së Vitisë.

**Rekomandimet:** Manifestimi Kulturo - Sportiv "Flakadani i Karadakut" të vazhdoj si një aktivitet i traditës në Komunën e Vitisë.

Viti, MAJ 2024

Drejtori i DKRS:

/ Valmir Sahiti /

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 13-05-2024 Viti

| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
|---|---|---|---|
| 01- | 016/ | 01- | 710 |

Komuna Vitisë
OpstinaVitina
Municipal Vitina

**Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural**
**Nr. 10**
**Datë: 12.03-29.04.2024**
**VITI**

## Informatë për mbjelljet pranverore-2024

**Në formë tabelare janë paraqitur të dhënat e aplikuesëve për subvencione sipas kritereve të MBPZHR- 2024**

| Nr. | Kultura Lavërtare | Sipërfaqja në hektar | Nr. i fermerëve |
|---|---|---|---|
| | Misër / mbi – 1/ha | 2045.30 /ha | 652 |
| | Elb/mbi-1/ha | 3.94/ha | 2 |
| | Thekër/mbi 1/ha | 3.52/ha | 2 |
| | Gjithësej | 2,052.76/ha | |
| | Bimë Industriale | | |
| | Lulediell | 41.84/ha | 2 |
| | | | |
| | Bimë mjekuese aromatike | 3.99/ha | 2 |
| | Perim-kulturë- mbi 0,30/ha | | |
| | Patate | 84.92/ha | 72 |
| | Shalqin | 58.02/ha | 45 |
| | Pjepër | 9.09/ha | 18 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Lakër | 14.39/ha | 19 |
| | Kungull | 44.24/ha | 48 |
| | Spec | 5.62/ha | 7 |
| | Fasule | 132.18/ha | 69 |
| | Kunguj misiri | 19.92/ha | 22 |
| | Qepë | 7.74/ha | 10 |
| | Tranguj | 0.20/ha | 1 |
| | Gjithësej perime në fushë të hapur | 381.32/ha | |
| | Perime në serra | 5.02/ha | 12 |

**Drejtori i Bujqësisë**

**Naim Pira**

për [signature]